

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i Trupit Gjykses Xhevdet Elshani dhe Teuta Krusha e Shpresa Emra, anëtar, me praktikantin e kësaj gjykate Shqipron Krasniqi, duke vendosur në lëndën penale ndaj të akuzuarve: V. S. dhe K. S., që të dy nga fsh. N., Komuna e Malishevës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.72/16, të datës 10.06.2016, për shkak të veprave penale: në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189, par. 1 nënpar. 1 lidhur me nenin 31 të KP-së, në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188, par. 2 lidhur me par. 1 nënpar. 1.4 të KP-së, në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188, par. 1 r. 1 nënpar. 1.4 të KP-së si dhe V. S. për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374, par. 1 të KP-së, para paraqitjes së Marrëveshjes për Pranimin e Fajësisë PP.nr. 72/2016, të datës 29.07.2016 e pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 05.08.2016 dhe seancës për pleqërim dhe votim në të njëjtën ditë, në prezencën e të akuzuarve, respektivisht mbrojtësve të tyre, av. S. M. dhe B. K., Prokurorit të shtetit Genc Nixha, me dt. **05.08.2016**, morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarve:

I. V. S., nga i ati B. dhe e ëma Rr., e lindur P., i lindur me datë ..., në fsh. N., Komuna e Malishevës ku dhe jeton, i martuar – babai i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion fermer, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

II. K. S., nga i ati S. dhe e ëma N., e lindur D., i lindur me datë ..., në fsh. N., Komuna e Malishevës ku dhe jeton, i martuar – babai i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion bujk, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORË

1. Të akuzuarit V. S. dhe K. S.:

I. Se me datën 15.03.2016, rreth orës 11:30 min në Suharekë, në rr. “Xh. S.” te tregu i kafshëve “J.”, në bashkëkryerje i shkaktojnë lëndime të rënda trupore, të cilat rezultojnë me dëmtim dhe me dobësim të përkohshëm të një pjese vitale të trupit, të dëmtuarit M. S., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje të më hershme që kishin në mes tyre lidhur me një çështje pronësore derisa i dëmtuari ishte në tregun e kafshëve duke shitur disa dhe mjete bujqësore së bashku me vëllezërit R. dhe S. S., të akuzuarit e sulmojnë fizikisht të dëmtuarin duke e goditur me grushta, mjete të forta – shufra hekuri dhe shkopinjë prej druri, në kokë dhe në pjesë të ndryshme të trupit dhe, si pasojë e goditjeve i shkaktojnë lëndime të rënda trupore – ndrydhje në kokë dhe thyerje në parakrahun e majtë më për së afërmi të përshkruar në mendimin e ekspertizës mjeko – ligjore të Dr. M. G., të dt. 30.03.2016.

Me këtë veprim në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189, par. 1 nënpar. 1 lidhur me nenin 31 të KP-së.

II. Se me datën, kohën dhe vendi e njëjtë të përshkruar si në dispozitivin I të akuzës në bashkëkryerje i shkaktojnë lëndime të lehta trupore me mjet të rrezikshëm apo sende që mund të shkaktojnë lëndim të rëndë trupor të cilat rezultojnë me dëmtim të përkohshëm të një pjesë të trupit, të dëmtuarit R. S., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje të më hershme që kishin pas në mes tyre lidhur me një çështje pronësore derisa i dëmtuari ishte në tregun e kafshëve duke shitur vegla dhe mjete bujqësore së bashku me vëllezërit M. dhe S. S., të akuzuarit e sulmojnë fizikisht të dëmtuarin duke e goditur me grushta, mjete të forta – shufra dhe shkopinjë prej druri, në kokë dhe në pjesë të ndryshme të trupit dhe, si pasojë e goditjeve i shkaktojnë lëndime të lehta trupore – ndrydhje në kokë dhe në krahun e majtë, më për së afërmi të përshkruar në mendimin e ekspertizës mjeko – ligjore të Dr. M. G., të dt. 30.03.2016.

Me këtë veprim në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188, par. 2 lidhur me nenin 31, nënpar. 1.4 të KP-së.

III. Se me datën, kohën dhe vendi e njëjtë të përshkruar si në dispozitivin I të akuzës në bashkëkryerje i shkaktojnë lëndime të lehta trupore të cilat rezultojnë me dëmtim të përkohshëm të një pjesë të trupit, të dëmtuarit S. S., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje të më hershme që kishin pas në mes tyre lidhur me një çështje pronësore derisa, i dëmtuari ishte në tregun e kafshëve duke shitur disa vegla dhe mjete bujqësore së bashku me vëllezërit M. dhe R. S., të akuzuarit e sulmojnë fizikisht të dëmtuarin duke e goditur me grushta dhe mjete të forta, në pjesën e shpatullës dhe, si

pasojë e goditjeve i shkaktojnë lëndime të lehta trupore – ndrydhje me gërvishtje në regjionin e djathtë shpatullor më për së afërmi të përshkruar në mendimin e eskpertzës mjeko – ligjore të Dr. M. G., të dt. 30.05.2016.

Me këtë veprim në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188, par. 1, nënpar. 1.4 të KP-së.

2. I akuzuari V. S.,

ËSHTË FAJTOR

IV. Se, me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitivin I të aktgjykimit gjatë kontrollit të policisë, pas një mosmarrëveshje dhe zënke që kishtë me të dëmtuarin, në automjetin e tij të markës “Mitsubish Pajero” me targa të regjistrimit xx-xxx-xx, mbanë në pronësi armën e zjarrit – pistoletën e markës CZ VZOR 50, me nr. serik 057449, të cal. 7.65mm, me ngjyrë të zezë, në shkelje me ligjin e zbatueshëm për armë të tilla.

Me këtë veprim ka kryer veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374, par. 1 të KP-së.

Andaj, Gjykata në mbështetje nenit 233 par. 2, dhe neneve 4, 7, 17.1, 31, 41, 42, 43, 45, 46, 73 si dhe 365 të KPP-së të akuzuarve u shqipton:

I. Të akuzuarin **V. S.**, për shkak të veprave penale se, në bashkëkryerje ka kryer veprën lëndim i rëndë trupor nga neni 189, par. 1, nënpar.1 lidhur me neni 31 të KP-së, lëndim i lehtë trupor nga neni 188, par. 2-1, nënpar.1.4 dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KP-së, i shqipton:

DËNIM ME BURGIM

- 1.** Për veprën penale nën I të dispozitivit, i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajve;
- 2.** Për veprën penale nën II të dispozitivit, i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve; dhe
- 3.** Për veprën penale nën III të dispozitivit, i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve.

Prandaj, Gjykata në mbështetje të nenit 80, par. 2 të KPK-së, bën unifikimin e dënimeve ashtu që, të akuzuarit **V. S.**, e:

G J Y K O N

Me dënim unik në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj burgim, në të cilin do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës **15.03.2016** e deri me ditën e sotme të datës **05.08.2016** si dhe, dënimin me gjobë në shumën prej 800 (tetëqindë) €uro, të cilën do ta paguaj në afat prej 15 dite e, nëse nuk e paguan do ti zëvendësohet me dënim burgimi në atë mënyrë që çdo 20 €uro nga shuma e dënimit të shqiptuar do ti llogaritet një ditë burgim.

DËNIM ME GJOBË

4. Për veprën penale nën IV të dispozitivit, i shqiptohet dënim me gjobë në shumën prej 800 (tetëqindë) €uro.
5. Gjithashtu ndaj të akuzuarit V. S. shqiptohet edhe,

DËNIMI PLOTËSUES

Ashtu që, nga i akuzuari **V. S.** konfiskohet arma e markës CZ VZOR 50, të prodhimit Çekosllovakia, me nr. serik 057449, e kalibrit 7.65mm, një karikator i zbrazët dhe 4 (katër) fishekë, si mjet i kryerjes së veprës penale.

- II. Të akuzuarin **K. S.**, për shkak të veprës penale se, në bashkëkryerje ka kryer veprën lëndim i rëndë trupor nga neni 189, par. 1, nënpar.1 lidhur me neni 31 të KP-së dhe lëndim i lehtë trupor nga neni 188, par. 2-1, nënpar.1.4 të KP-së, i shqipton:

DËNIM ME BURGIM

1. Për veprën penale nën I të dispozitivit, i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajve;
2. Për veprën penale nën II të dispozitivit, i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve; dhe
3. Për veprën penale nën III të dispozitivit, i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve.

Prandaj, Gjykata në mbështetje të nenit 80, par. 2 të KPK-së, bën unifikimin e dënimeve ashtu që, të akuzuarit **K. S.**, e:

G J Y K O N

Me dënim unik në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj burgim, në të cilin do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës **15.03.2016** e deri me ditën e sotme të datës **05.08.2016**.

Obligohen të akuzuarit që secili prej tyre të paguaj nga 100 € në emër të paushallit gjyqësor, në afat prej 15 dite, prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën ekzekutim të përmbarimit ligjor.

A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, me aktakuzën, PP.nr.72/2016, e datës 10.06.2016, ka akuzuar V. S. dhe K. S. për shkak të veprave penale se, në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189, par. 1 nënpar. 1 lidhur me nenin 31 të KP-së, në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188, par. 2 lidhur me par. 1 nënpar. 1.4 të KP-së, në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188, par. 1 r. 1 nënpar. 1.4 të KP-së si dhe V. S. për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374, par. 1 të KP-së. Prokuroria e Shtetit ka parashtruar Marrëveshjen mbi Pranimin e Fajësisë PP.nr.72/2016, të datës 29.07.2016, të hartuar nga ana e Prokurorisë së Shtetit – Prokuroria Themelore në Prizren, në njërën anë dhe të akuzuarve V. S. dhe K. S., respektivisht me mbrojtësit e tyre, av. S. M. dhe B. K., në anën tjetër, ku palët kanë përcaktuar kushtet e pranimit të fajësisë, është negociuar dhe propozuar edhe dënimi.

Në Marrëveshjen mbi Pranimin e Fajësisë të hartuar ndërmjet Prokurorisë Themelore në Prizren dhe të akuzuarve V. S. dhe K. S., palët kanë përcaktuar kushtet e pranimit të fajësisë, ku është negociuar dhe propozuar edhe dënimi.

Prokurori i Shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor ka ngelur në tërësi pranë aktakuzës, përkatësisht Marrëveshjes mbi Pranimin e Fajësisë.

Mbrojtësit dhe të akuzuarit nuk kanë pasur ndonjë vërejtje në aktin e Marrëveshjes mbi Pranimin e Fajësisë dhe të njëjtën e kanë konfirmuar.

Të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor kanë pranuar fajësinë për veprat penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për të cilat janë akuzuar nga Prokuroria Themelore në Prizren dhe njëkohësisht janë pajtuar me kushtet e Marrëveshjes mbi Pranimin e Fajësisë.

Gjykata, konsideron se marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të paraqitur nga Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr. 72/16, të datës 29.07.2016, e cila ka të bëjë me të akuzuarit V. S. dhe K. S., për shkak të veprave penale se, në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189, par. 1 nënpar. 1 lidhur me nenin 31 të KP-së, në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188, par. 2 lidhur me par. 1 nënpar. 1.4 të KP-së, në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188, par. 1 r. 1 nënpar. 1.4 të KP-së si dhe, V. S. për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374, par. 1 të KP-së dhe, deklarimin për pranimin e fajësisë nga të akuzuarit e kanë bërë në pajtim me dispozitat e nenit 233 par. 18 të KPP-së, të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë. Pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme dhe se, një pranim i tillë ka mbështetje në provat që i përmban aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.72/2016, e datës 10.06.2016, dhe atë deklarami i të akuzuarve, deklaramet e të dëmtuarve, dëshmitarëve, raportet mjekësore të Qendrës Emergjente në Suharekë dhe Prizren të datës 15.03.2016, arma e konfiskuar - CZ VZOR 50, të prodhimit Çekosllovakia, me nr. serik 057449, e kalibrit 7.65mm, një karikator i zbrazët dhe 4 (katër) fishekë, si dhe pas mendimit mohues të të dëmtuarëve, **aprovohet** në tërësi Marrëveshja për Pranimin e Fajësisë.

Të akuzuarit e kanë patur të qartë se, me pranim të fajësisë nuk do të ketë procedurë të provave ku i njëjti ka mundësi që ti kundërshtojë provat e aktakuzës dhe njëkohësisht të merr prova në mbrojtjen e tij. Përfundimisht, aktgjykimi i marrur në bazë të pranimit të fajësisë nuk mund të ankimohej për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin se, pas aprovimit nga Gjykata të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, të akuzuarit nuk kanë të drejtë të shprehen se nuk janë fajtor.

Prandaj, Gjykata në mbështetje të dispozitës së nenit 326, par. 1, aprovoj në tërësi marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe gjendjen faktike e mori ashtu si është shprehur në dispozitiv të aktakuzës, prandaj, gjeti këtë gjendje faktike se me të vërtetë të akuzuarit V. S. dhe K. S. janë fajtor për veprat penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet që të akuzuarit kanë kryer veprat penale të cilat u vihen në barrë dhe nuk ka rrethana për pushimin e procedurës, përkatësisht hudhjen e aktakuzës, prandaj, Gjykata e ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e

fajësisë PP.nr.72/2016, të dt. 29.07.2016 të lidhur në mes Prokurorit të Shtetit, mbrojtësve dhe të akuzuarve.

Gjykata nga të cekurat e lartpërmendura ka ardhur në përfundim se, me veprimet e të akuzuarve, formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale, të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit ti shpallë fajtorë dhe ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penalo – juridike të tyre.

Prandaj, Gjykata gjendjen faktike e mori në tërësi siç ishte përcaktuar në dispozitiv të aktakuzës dhe ka gjetur se me të vërtetë të akuzuarit kanë kryer veprat penale ashtu siç përshkruhet në aktakuzë dhe në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të të akuzuarve.

Gjykata, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e papranueshme dhe e marrë në kundërshtim konform nenit 257 të KPP-së, e cila do të vinte në mëdyshje dhe do të bënte të papranueshme pranimin e fajësisë. Gjithashtu, Gjykata konsideroj se, nuk ekzistojnë rrethana të përcaktuara nga neni 253 të cilat do të konsistonin në krijimin e rrethanave për hudhjen e aktakuzës.

Sa i përket dënimit, Gjykata të akuzuarit i gjykoi me dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, duke qenë i bindur se me një dënim të tillë tek të akuzuarit dhe në rrethin ku ata jetojnë, do të arrihet efekti i sanksionit penal që në të ardhmen të përmbahen nga veprimet e tilla inkriminuese dhe se një dënim i tillë i përgjigjet shkallës së përgjegjësive penale për të akuzuarit.

Të dëmtuarit nuk paraqesin kërkesën pasurore – juridike.

Me rastin e caktimit të dënimit, llojit dhe lartësisë së tij, për të akuzuarit, Gjykata e mori si rrethanë veçanërisht lehtësuese se të njëjtit e kanë pranuar fajësinë, kanë shprehur pendim të thellë dhe të sinqertë si dhe kanë premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejnë veprime të tilla inkriminuese.

Gjykata ka ardhur në përfundim se me dënim e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrihet efekti i sanksionit penal nga neni 41 të KP-së, edhe me dënimin e shqiptuar që, të akuzuarit tani e tutje të sillen sipas normave shoqërore dhe të njëjtat ti respektojnë.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor u murrë në kuptim të nenit 450 par.2.6 të KPP-së.

Me sa u tha u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi, e në mbështetje të nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.95/2016, të datës 05.08.2016

Praktikanti,
Shqipron Krasniqi

Kryetari i trupit gjykues
Xhevdet Elshani

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, prej ditës së marrjes kopjes së të njëjtit, përveç për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin. Ankesa i ushtrohet Gjykatës Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet Gjykatës Themelore në Prizren.